

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.1.08.2023*

1.08.2023  
Ora 12:05

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, zotit Edison Selman Memolla, të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për zgjedhjet e përsëritura të datës 23 Korrik 2023”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
  - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
  - **Stafi KQZ: Znj. Pavlina Doçaj**
- **Parti Politike: S’ka prezent**
- **Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita, në seancën e sotme kemi në rend dite:

Projektvendimi që lidhet me dhënien e mandatit në zgjedhjet për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, si dhe,

Dy projektvendime që lidhen me plotësimin e vakancave për anëtarë të këshillave bashkiakë, për Këshillin e Bashkisë Dibër dhe këshillin e Bashkisë Lezhë.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me dhënien e mandatit në zgjedhjet për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë. Po, Pavlina!

**Znj. P. Doçaj:** Pas zhvillimit të procesit zgjedhor të datës 23.07.2023, në referim të nenit 166, ku thuhet se, “kandidati fitues është ai kandidat që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse”. Bazuar në nenin 33, shkronja “g”, KZAZ-ja nr. 43, me vendimin nr. 118, datë 24.07.2023 ka shpallur fitues zotin Edison Selman Memolla, si kryetar të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.1.08.2023*


Bashkisë Rrogozhinë. Në këto kushte në referim të nenit 19, pika 1 dhe në referim të nenit 166 të Kodit Zgjedhor, i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, zotit Edison Selman Memolla, i propozuar nga subjekti zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Bazuar në rezultatin e zgjedhjeve të përsëritura për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, vendosim:

- Dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, zotit Edison Selman Memolla, të propozuar nga subjekti zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 718**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.1.08.2023*

**1.08.2023  
Ora 12:07**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në këshillat bashkiakë”.**


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
  - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
  - **Stafi KQZ:                   Znj. Pavlina Doçaj**
- **Parti Politike:               S’ka prezent**
- **Të tjerë:                     KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës, për plotësimin e vakancave të këshillave bashkiakë.

**Znj. P. Doçaj:** Kemi dy vakanca, në Këshillin e Bashkisë Dibër dhe në Këshillin e Bashkisë Lezhë. Për sa i përket vakancës së parë dhe të dytë, janë depozituar nga kandidatët vijues të listës shumëmemërorë, formularët e vetëdeklarimit. Nga deklaratimet e dhëna në formularin e vetëdeklarimit rezulton se nuk ka asnjë të dhënë të parashikuar në ndalimet e ligjit 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kryer verifikimet përkatëse për të dy kandidatët e listës shumëmemërore në Drejtorinë Gjendjes Civile dhe atë të Gjendjes Gjyqësore. Në të dy komunikimet elektronike na është kthyer përgjigje që, për të dy kandidatët nuk ka ndryshime në përbërjet e gjendjes gjyqësore dhe nuk ka vendime penale të formës së prerë. Gjithashtu nuk ka asnjë gjeneralitet të ndryshuar për të dy kandidatët. Në këto kushte, në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, të dhënat e

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.1.08.2023*

deklaruara, nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e të dy kandidatëve në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimet përkatëse.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate zonjën Marjana Kadria.
  - Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Kristian Demokrate zotin Shtjefën Lleshi.
- Çështje të tjera nuk kemi?

**Znj. P. Doçaj:** Jo, nuk kemi.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Seanca mbyllet, ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 719, 720**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

